



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.282, datë 24.10.2022

PËR

“MIRATIMIN E RELACIONIT MBI VERIFIKIMIN E PASURISË DHE FIGURËS SË KANDIDATES PËR T’U PRANUAR NË PROGRAMIN E FORMIMIT FILLESTAR TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS, NË VITIN AKADEMIK 2022-2023, ZONJA MARILDA FRASHËRI”

Bazuar në nenin 149/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 159, pika 2, germa “a” dhe 161 të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenit 32 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Seksionit VI dhe VII të Rregullores “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe zhvillimin e karrierës së prokurorëve” i ndryshuar, si dhe pasi u njoh me Relacionin “Mbi verifikimin e pasurisë dhe figurës së kandidatës për Programin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës në vitin akademik 2022-2023, zonja Marilda Frashëri”, të përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Relacionit mbi verifikimin e pasurisë dhe figurës së kandidatës Marilda Frashëri, sipas tekstit bashkëlidhur.
2. Lejimin e kandidatës për t’u pranuar në Programin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës, në vitin akademik 2022-2023.
3. Të njoftohet për këtë vendim zonja Marilda Frashëri dhe Shkolla e Magjistraturës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
5. U shpall në Tiranë, sot më 24.10.2022.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETAR
Alfred Balla

ZV/KRYETAR
Tartar Bazaj



ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Bujar Sheshi

ANËTAR
Nurihan Seiti

ANËTAR
Elaida Goxhi

ANËTAR
Esmeralda Keshi

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Arta Mandro

ANËTAR
Mirela Bogdani